

Policy Memo

DREJTËSIA E TRANZITIMIT PËR PERIUDHËN PAR KRIZËS NË REPUBLIKËN E

Nëntor 2018

Tentimet për normalizimin e një shoqërie e cila sapo ka dalë prej krize të thellë, kurse koeficienti i sajë i thyeshmërisë akoma është i lartë, me saktësisht i njëjtë me atë nga viti 2015,¹ me ndihmë të metodave legalistike, në korniza klasike institucionale dhe gjyqësore, nuk mundën të japin fryte të qëndrueshme në afat të gjatë. Shoqëritë e ndara në fillim duhet të shërohen si shoqëri që më tej të themelohet qeverisje funksionale e së drejtës. Literatura referuese dhe organizatat me autoritet ndërkombëtarë në lidhje me *drejtësinë e tranzitimit* konfirmojnë se sistemi gjyqësor nuk ka fuqi për thithje të një numër kaq të lartë të rasteve por dhe të rasteve me natyrë më komplekse dhe referon në ndarjen esenciale politike dhe jo në sjelljen kriminale. Kur bëhet fjalë për polarizimin shoqëror, fajësia ose përgjegjësia shpesh herë ekzistojnë në kuptim moral dhe në kuptimin e përgjegjësisë shoqërore dhe është shumë vështirë që të përshtatet në përgjegjësinë ligjore. Për shembull, agitator, qytetarë të polarizuar të cilat vetëm e ashpërsojnë fjalimin publik, mundën të kontribuojnë për thellësimin e krizës edhe pse faji i tyre, ndoshta, do të mbetet i pavërtetueshëm në gjyq.

Por, megjithatë, pavarësisht nga ajo se vallë janë të vërtetueshme të gjitha kategoritë të fajit në një shoqëri të ndarë dhe pavarësisht nga ajo se vallë sistemi gjyqësor ka fuqi praktike që ti thithë të gjitha rastet të cilat janë të nënshtruara në proqesim të gjyqit, argumenti kyç për ofrim kah instrumentet të *drejtësisë të tranzitimit* është vijuesi: në vend që të gjykohet dhe të dënohet, prioritet më i madh dhe më i rëndësishëm është pajtimi dhe shërimi i qelizave shoqërore. Gjyqet e shtetit bëhen të pakuptimshme atëherë kur në shoqërinë mbizotëron shkatërim në pikpamje të marëdhënies të shëndosha dhe produktive duke funksionuar në ndarje pothuajse të tërësishme. Pastaj, më shumë se dy vite krizë politike, recidivet e sajë përcillen deri në ditën e sotme, jostabiliteti i prolonguar i cili disa herë na solli deri në skaj të krizës të sigurimit (për shembull, tragjedia në Lagjen e trimave në vitin 2015), shoqëria e Maqedonisë në fillim duhet

të shërohet, dhe për të shëruar, nevojitet që të dy anët e kundërshtuara politike të ndëgjojnë njëri tjetrin, duke u përpjekur të kuptojnë të vërtetën të anës kundërshtare.

Praktika e *drejtësisë së tranzitimit* mundëson metoda për përcaktim të së vërtetës gjatë periudhës së krizës, kurse qëllimi është që të mundësohet pajtim kombëtar. Kështu, në fund, do të krijohen kushte për shqyrtim gjyqësor të së drejtës e cila është e përcjellur me rekomandime për amnesti të shkallëzuar. Komisionet për drejtësinë e tranzitimit ndonjëher rekomandojnë dhe amnesti të plotë (edhe pse zakonisht, rastet serioze si krimet e luftës, ose ngjajshëm, nënshtrohen në zgjidhje gjyqësore).

Në këtë kuptim, parlamentit të Maqedonisë i rekomandojmë

- Ti ndjekë drejtimitet e trupave si Zyra e kome-sarit për të drejtat e njeriut të Kombeve të bashkuara dhe drejtimitet e sajë për shqyrtimin e së drejtës së tranzitimit.² Aty propozohen më shumë metoda, ndër të cilat ajo e shqyrtuar në Afrikën e Jugut – komisionet e së vërtetës dhe pajtimin, ndëgjimi i të cilave zakonisht është publik, drejtësi e tranzitimit e shkallëzuar, amnesti si dhe proqesime të gjyqit në raste të caktuara.
- Ti pranojë drejtimitet për organizimin sistematik të proqesit të dhëna nga organizatat siç është përmendur më parë Zyra e KB por dhe Qendra ndërkombëtare për drejtësinë e tranzitimit duke themeluar rregulla dhe afate të punës (terms of reference) në përputhshmëri me praktikën më të mirë.
- Të themelojë Komision nga personat të cilat posedojnë reputacion dhe përjetohen si neutral, ajo shpesh herë nënkupton dhe kyçje të autoriteteve ndërkombëtare të cilat nuk duhet në mënyrë të domosdoshme të jenë jurist, por edhe shpesh herë nuk janë (mundet të jenë shkrimtarë, aktivist, kleri i lartë religjioz etj., por, gjithashtu edhe juristë).
- Ta zbatojë drejtësinë e tranzitimit të shkallëzuar, në të cilën do të ekzistojnë misionet e së vërtetës dhe pajtimin, sesione të cilat do të jenë publike dhe, duke ndjekur shembullin të zbatuar nga ana e Nelson Mandellës në Afrikën Jugore, me këtë do të mundësohet pranimit dhe falje, por edhe proqese të gjyqit për raste ku akti i pranimit dhe faljes janë përgjigje e pamjaftueshme në aspekt të drejtësisë (duke marrë parasysh rëndësinë e veprës).

¹ Fragile States Index 2018, released by the Fund for Peace, available at <http://fundforpeace.org/fsi/countrydata/>, accessed on 1 September 2018.

² Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights: *Rule-of-Law Tools for Post-Conflict States*. United Nations: New York and Geneva, 2006.

- Drejtësia e tranzitimit të shkallëzuar kyç dhe amnesti të pjesërishtme, rekomandojmë të zbatohen jo vetëm për persona të caktuar të lidhur me rastin e 27 prillit të vitit 2017, por edhe për pjesëmarësit të Revolucionit laraman për ata për të cilat ende proqesohen proqese në gjyq për vepra të cilat aspak nuk kanë kërcënuar jetën e askujt, përderisa dëmi material të cilin e kanë prodhuar është rezultat i polarizimit shoqëror i cili në atë moment ka patur karakteristika të revolucionit (me përmendje: drejtësia e tranzicionit është e zbatueshme fillimisht në raste të revolucionit dhe ndërrimit të regjimit).³
- Duke marrë parasysh se drejtësia e tranzitimit që do të duhet të zbatohet është e shkallëzuar, pranë amnestionit të pjesërishtëm, do të nevojitet dhe proqesin nga ana e gjyqit të rasteve për të cilat komisioni për të vërtetën dhe pajtimin do të mbledhë të dhëna të mjaftueshme se ka ekzistuar tentim për likvidim fizik, sulm teroristik dhe ngjajshëm.

³ Me përndjekje penale janë Mariglen Demiri, Zdravko Saveski dhe Vlladimir Kunovski, ndërsa me akuzë për kundërvajtje janë Mirjana Najçevska, Branko Triçkovski, Simona Spirovska, Zamir Mehmeti etc.